
Permbajtja Jo-Teknike

**NDERTIM DHE FUNKSIONIM TE
UZINES SE FERRO-KROMIT
Fshati SUC, Bashkia BURREL, Rrethi
MAT.**

Mars 2018

Permbajtja

1.1	Përshkrimin e qëllimit të projektit të propozuar	3
1.2	Planimetria e vendndodhjes së projektit (siperfaqja, koordinatat Gaus Kruger)	3
1.3	Përshkrim i proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasi të e lëndëve të para dhe produktet final.	5
1.3.1	FAZA I-Ndërtimi i Uzines	5
1.3.2	FAZA II-Funksionimi i Uzines	9
1.4	Infrastruktura e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja	20
1.5	Programi për kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit dhe fazën e rehabilitimit.....	20
1.6	Lendet e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji).....	21
1.7	Informacion për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës të projektit	22
1.8	Përdorimin e lendeve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasi të ujit të nevojshëm, energjisë, lendeve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre	22
1.9	Aktivitetet e tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.	23
1.10	Analizimi i alternativave të mundshme për zbatimin e projektit	23
1.11	Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin të kërkuara nga legjislacioni në fuqi si dhe institucionet kompetente për lejimin/autorizimin/liçencimin e projektit	24

1.1 Përshkrimin e qëllimit të projektit të propozuar

Rezervat e konsiderueshme të xeherorëve të kromit në zonën e Bulqizes dhe Martaneshit bëjnë të mundur jo vetëm prodhimin e këtyre xeherorëve për eksport, por krijojnë edhe mundësinë e përdorimit të tyre për prodhimin e ferrokromit me karbon të lartë dhe në një fazë të mëtejshme me karbon të ulët, që janë bazë për prodhimin e celiqeve të markave të ndryshme dhe vecanërisht të celiqeve të pa oksidueshëm. Gjithashtu edhe ngritja e shumë hidrocentraleve lokale në këtë zonë e favorizon së tepërmi prodhimin e ferrokromit me karbon të lartë. Për këtë qëllim është parashikuar ngritja e Uzinës së prodhimit të ferrokromit me karbon të lartë pranë fshatit Suç, Bashkia Burrel.

1.2 Planimetria e vendndodhjes së projektit (siperfaqja, koordinatat Gaus Kruger)

Objekti do të ngrihet në një shesh ndertimi që është pjesë e Fshatit Suç, Bashkia Burrel, Rrethi Mat. Vete fshati Suç ka qenë ish komune, me reformën e re territoriale, sot është pjesë e Bashkisë Burrel. Zona ku përfshihet dhe fshati Suç është në përgjithësi një zonë kodrinore me lumenj dhe përrenj që e përshkruajnë të gjithë atë. Është i vendosur në juglindje të qytetit të Burrelit, në afërsi të lumit Mat. Sheshi ku do të ndertohej uzina është fushorë, pjesë e lugines së lumit Mat, rreth 400 m nga rruga nacionale Tirane – Peshkopi, me një lartësi prej 208 m mbi nivelin e detit dhe shumë afër lumit Mat.

Koordinat në Gaus-Kryger të vendndodhjes së uzinës së ferro-kromit të shoqërisë A.S.C.Cr sh.p.k

Nr.	X	Y
1	4421084.55	4603530.58
2	4421209.73	4603518.50
3	4421287.67	4603442.75
4	4421207.82	4603343.74
5	4421047.07	4603377.61
6	4421091.32	4603494.83
7	4421003.91	4603433.20
8	4420981.38	4603375.49
9	4420990.44	4603344.62

Tabela 1. Koordinatat në Gaus-Kryger




Figura 1. Pamja nga Google Earth Uzinen se Ferro-Kromit, Shoqeria A.S.C.Cr sh.p.k




Figura 2. Harta topografike e zones ne Uzinen se Ferro-Kromit, Shoqeria A.S.C.Cr sh.p.k (Burimi Asig.gov.al).

1.3 Përshkrim i proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet final.

1.3.1 FAZA I-Ndërtimi i Uzines

Infrastruktura

Ne planimetrinë perkatese janë dhënë detaje të zonës në lidhje me infrastrukturen, duke përfshirë, linjen elektrike, rruga lokale që do të lidhet me rrugën nacionale, linja e furnizimit me ujë, pikat e shkarkimeve të objekteve të tjera .

Transformatori që do të furnizojë uzinen do të jetë **16000 KWA**, i cili do të ushqehet prej rrjetit kombëtar 110 KW nga linja e tensionit të lartë Burrel-Bulqize që shtrihet në afërsi dhe përgjatë rrugës nacionale.

Janë parashikur sisteme kanalizimesh dhe drenazhimesh sepse terreni është kodrinor dhe fushor, dhe do të shfrytëzohen si për shkarkimin e ujrave sipërfaqësor ashtu dhe higjieno-sanitare. Një rrugë rreth 400 m (trase ekzistuese) do të lidhet me rrugën nacionale dhe nuk paraqet ndonjë problem të trafikut të zonës.

Sheshi i ndërtimit ndodhet në një zonë me një pjerrësi shumë të vogël, më pak se 2°, ku sipërfaqja e sheshit do të nënshtrohet punimeve të ndërtimit dhe sistemimit. Parcela e vendosur në këtë është e lirë dhe nuk ka asnjë ndërtim ekzistues në afërsi që mund të funksionojnë së bashku me ato që propozohen.

Zgjedhja e kësaj parcele është bërë për dy arsye kryesore, së pari ndodhet në afërsi të burimeve minerare dhe së dyti struktura dhe horizontaliteti i tij ndihmon në kompozimin dhe ndërtimin e objekteve për një proces teknologjik sa më optimal.

Në këtë shesh të parashikuar për ndërtimin nuk ka zona si burime natyrore dhe mjedise pyjore, por në afërsi të saj ndodhen zona pyjore të dëmtuara, por jo me potencial zhvillimi pyjor në të ardhmen. E gjithë zona është e lirë nga pyjet dhe nuk ka asnjë objekt tjetër ndërtimor pranë saj.

Zona për zhvillim nuk ka objekte me status "monument kulture", "zonë historike" dhe as sipërfaqe me status "zonë arkeologjike" ose "zonë e mbrojtur".

Zona që zhillohet është një zonë e pazhvilluar nga ana urbanistike, megjithatë strukturat që do të zhvillohen në këtë zonë do të respektojnë ambientin rrethues. Ndërtimi do të bëhet pjesërisht i zbuluar, por pjesa më e madhe e objektit do të jetë e mbuluar. Arkitektura është e thjeshtë dhe respekton linjat e pastra gjeometrike dhe kuadratike në strukturat e zhvilluara. Duke qenë një objekt industrial qëllimi kryesor është funksionimi normal i teknologjisë dhe puna pa ndërprerje e fabrikës duke respektuar edhe një harmonizim të reparteve, normat për hyrje-daljet dhe qarkullimin e njerëzve, automjeteve edhe mallrave, ngjyrat që duhet të përdoren, materialet që duhet të përdoren, lartësitë e ambjentëve etj. Nga projektimi mbi bazat e normativave për këto tipe ndërtimesh, përftojmë volume të ndryshme, të cilat rrinë në harmoni me njëra-tjetrën dhe lidhen me struktura metalike karakteristike për këtë lloj arkitekture

Ndërtimi i Uzines do të ndjekë vetëm një fazë zhvillimi. Periudha kohore e parashikuar nga fillimi deri në përfundimin e punimeve sipas grafikut të punimeve parashikohet rreth 2 muaj dhe përfshin:

Ndërtimin e reparteve teknologjike, rrugëve të brendëshme, linjën elektrike të tensionit të lartë, stacionet e pompave dhe linjën e ujit teknologjik, montimin e makinerive dhe instalimet teknologjike. Me perfundimin e tyre Uzina do të vihet në punë.

Për ndërtimin e strukturës së objekteve që propozohen nevojitet kryerja e punimeve të gërmimit. Gërmimi duhet për themelet të cilat janë menduar të zgjidhem me struktura masive betoni të armuar. Këto themele do të shërbejnë njëkohësisht edhe si dysheme të reparteve të fabrikës.

Volumi i dherave i parashikuar që do të dalë nga gërmimi dhe nga kryerja e punimeve do të përdoret për krijimin e digës së sterileve.

Per punimet e ndertimit, kompania do te perdor inerte, uje e çimento te cilat sigurohen direkt nga subjektet e licensuara.

Konkretisht :

-Rreth **10 000 m³** betone,

-çimento mbi **250 ton**

- hekur per konstruksione metalike rreth **1000 ton etj.**

Keto do te sakesohen me perfundimin e projekteve te zbatimit

Theksojme se keto nevoja nuk do te kene ndonje ndikim ne furnizimin e zones apo impakte te tjera mjedisore.

Projekti parashikon keto objekte ne uzines e Ferro-Kromit te shoqerise A.S.C.Cr sh.p.k

-Depoja e pastes se elektrodave (14)

-Depoja e Koksit (16)

-Sistemi i dozimit te materialit (15)

-Reparti furrave te shkrirjes

-Reparti derdhjes se ferrokromit

-Reparti thyerjes, sitisjes dhe ambalazhimit te ferrokromit

-Reparti granulimit te skorjes (30,31)

-Reparti pastrimit te gazrave te fures (36,37,38,39)

-Sistemi i ftohjes, zbutjes dhe qarkullimit te ujit (40,41,42,43)

-Nenstacioni elektrik (45)

-Oficina dhe repartet ndihmese te saj (8,9,10)

-Zyrat, laboratorit dhe ambientet sociale (4,5,6,7)

-Peshorja e automjeteve (12)

-Sheshi depozitimit te mineralit te kromit dhe lendeve te para (18)

Ky repart i lendeve te para sherben per te depozituar keto materiale dhe parapergatitur ato.

Pajisjet kryesore te ketij reparti jane

-Pajisjet e transportit te materialeve

-Pajisjet tharese

-Pajisjet thyerse te materialeve

-Pajisjet e pastrimit te pluhrave

- Depoja e pastes se elektrodave (14)
- Depoja e koksit (16)
- Sistemi i dozimit te materialit (15)

Repartet kryesore perberese te uzines

- Reparti furrave te shkrirjes i cili sherben per shkrirjen e materialeve dhe perbehet nga keto pjese kryesore:
 - Stacioni i pergatitjes se ngarkeses perfshi transportierin me shirit
 - Skipi i transportimit te materialit
 - Furra 9 MVA
 - Filtri i gazrave te fures
 - Filtri i gazrave te makinave te derdhjes
 - Vinci 15 ton
 - Makina e hapjes dhe mbylljes se vrimave te metalit dhe skorjes
 - Reparti derdhjes se ferrokromit
 - Reparti thyerjes, sitisjes dhe ambalazhimit te ferrokromit
 - Reparti granulimit te skorjes (30, 31)
 - Reparti pastrimit te gazrave te fures (36, 37, 38, 39)
 - Sistemi i ftohjes, zbutjes dhe qarkullimit te ujit (40, 41, 42, 43)
 - Nenstacioni elektrik (45). Nenstacioni elektrik perfshin: Transformatorin e fuqise dhe kabinetin e riparimit elektrik te celesave.
 - Oficina dhe repartet ndihmese te saj (8, 9,10). Ky repart sherben per prodhimin e kemishave te elektrodave, per sherbimin dhe mirembajtjen e paisjeve e makinerive te uzines.
 - Zyrat, laboratorit dhe ambientet sociale (4, 5, 6, 7). Sherben per te bere analizat kimike te lendeve te para dhe te produktit te gatshem. Jane te instaluara dhe pajisjet per analizimin e karbonit, squfurit si dhe pajisjet normale per analizimin e Ferrokromit.
 - Peshorja e automjeteve (12). Do te sherbeje si per peshimin e lendeve te para, ashtu edhe te ferrokromit te prodhuar.

Makineri – Pajisjet Kryesore

- Sistemi i furnizimit te fures
- Trupi i Fures,
- Sistemi i largimit te gazrave
- Kollonat e elektrodave
- Manteli metalik i elektrodes
- Pasta e elektrodave
- Sistemi i frenimit te elektrodave
- Sistemi i ngritje - ulje te elektrodave
- Sistemi i udhezimit te elektrodave
- Sistemi i ftohjes se mantelit metalik te fures

- Transformatori i furres (Tre fazor AC)
- Pajisja e shkarkimit te gazeve
- Sistemi i ftohjes me uje
- Sistemi hidraulik
- Pajisjet elektrike te furres



Figura 3. Rruga ekzistuese ne afersi te objektit dhe lidhja e saj me rrugen nacionale jepen ne fotot e meposhteme

1.3.2 FAZA II-Funksonimi i Uzines

- **Pershkrim i pergjithshem**

Kapaciteti prodhues i ferrokromit do te jete afersisht per **19300 ton/vit ose 58 ton/dite**. Per prodhimin e ferrokromit me karbon te larte, do te instalohet nje furre elektrike mineralo-reduktuese me hark e hapur.

Lendet e para qe do te perdoren do te jene mineral kromi kokerr me permbajtje 40 % Cr₂O₃ si dhe koncentrat kromi ne sasine maksimale 20%, me permbajtje 48 % Cr₂O₃. Si reduktues do te perdoret koksi metalurgjik me permbajtje Cf min. 85%. Ne rolin e flusuesit do te jete kuarci dhe ne raste te vecanta te domosdoshme edhe baoksiti.

Kapaciteti i tranformatorit te fures do te jete 12000 kWA, ndersa transformatori qe do te furnizoje uzinen do te jete 16000 kWA, i cili do te ushqehet prej rrjetit kombetar 110 kW nga linja e tensionit te larte Burrel - Bulqize.

- **Parametrat kryesore teknologjik**

Parametrat e meposhtem jane percaktuar ne perputhje me eksperiencen me te mire dhe afatgjate te specialisteve shqiptare dhe italiane te kesaj fushe si dhe me eksperiencen shqiptare ne Burrel dhe Elbasan. Ne database te projektit te fures jane inkorporuar edhe standartet teknike te mbledhura gjate debateve e diskutimeve me specialistet dhe prodhuesit kineze te furrave.

Sasia e HCFeCr te prodhuar nga furra prej 12000 kWA cdo vit llogaritet ne kete menyre:

Konsumi i energjise per njesi e HCFeCr supozohet qe do te jete 4200 kWh/t.

$Q=S \times \text{Cos}(fi) \times K1 \times K2 \times K3 \times 24 \times d / w$	(t/vit)
S- Kapaciteti i transformatorit (KVA)	12000
Cos(fi)- Faktori i fuqise se fures	0,9
K1- Faktori i fuqise se disponueshme	1.0
K2- Faktori i disponushmerise se kohes	0.95
K3- Faktori i luhatjes se tensionit	1.0
d- Ditet e punes ne vit	330
w- Konsumi i energjise per njesi te produktit	4200kWh/ton
Si rezultat prodhimi vjetor i fures do te jete	Q = 19300 ton

Nr	Emertimi	Njesite	Specifikime	Shenime
1	Fuqia e transformatorit	kWA	12000	Koha mbng.30 %
2	Tipi i fures		Hapur	
3	Produkti		HCFeCr	
4	Prodhimi ditore	mt	58	
5	Prodhimi vjetore	mt	19300	330 dite
6	Nr.derdhjeve	Nr.	8	Ne 24 ore
7	Sasia mes.per derdhje	mt/derdhje	7.4	
8	Sasia max.per derdhje	mt/derdhje	8.0	
9	Diam.i elektrodave	mm.	900	

10	Diam.i shperndarjes se elektrodave	mm.	22887+/-100	
11	Diametri I jashtem i furres	mm.	8600	
12	Diam.i karkases se furres	mm.	6800	Diametri i jashtem
13	Lartesia e furres	mm.	4500	
14	Tensioni sekondare	W	115-142-163	3v/17 shkalle
15	Tensioni i punes sek.	W	148	
16	Dens.korentit elektroda	A/cm ²	5.52	
17	Faktori i fuqise	Cos(ϕ)	0.9	
18	Korsa.e veprimit te elektrodës	mm.	1200	
19	Korsa max.e veprimit te elektrodës	mm.	1600	
20	Temp.e gazit	°C	90-350	
21	Sasia e gazit te prodhuar	m ³ /h	210000	

Tabela 2.Treguesit kryesore per uzinen e ferro-kromit te shoqerise “A.S.C.Cr” sh.p.k

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Shenime
1	Konsumi i energjise	kWh/ton	4200	
2	Mineral kromi	Kg/ton	2789	
3	Koks	Kg/ton	540	
4	Kuarc	Kg/ton	420	
5	Paste elektrode	Kg/ton	30	

Tabela 3.Konsumi materaleve per prodhimin e nje ton ferrokrom me permbajtje te larte karboni

Nr.	Emertimi	Njesia	Sasia	Shenime
1	Mineral kromi 40%	Ton/vit	53800	Vlera e references
2	Koks metalurgjik	Ton/vit	10420	Vlera e references
3	Kuarc	Ton/vit	8100	Vlera e references
4	Paste elektrode	Ton/vit	580	Vlera e references

Tabela 4.Konsumi vjetor i lendeve te para

Uzina sic shihet edhe nga planimetria e pergjitheshme e saj perbehet nga keto reparte kryesore:

- Reparti furrave te shkrirjes
- Reparti Derdhjes
- Reparti i Lendeve te para
- Reparti i Thyerjes
- Reparti Produktit te gatshem
- Reparti Perpunimit te Skorjes (Granulimit)
- Ftohja dhe Trajtimi Ujit
- Reparti Mirembajtjes
- Zyra – Reception
- Nen Stacioni Elektrik
- Peshore
- Stacioni Pompimit

- Dampa per skorjet

- **Pershkrimi i Procesit teknologjik te prodhimit dhe funksionimi i uzines**

Ferrokromi me karbon te larte prodhohet nga shkrirja e mineralit te kromit, ne rastin tone me permbajtaje rreth 40% Cr_2O_3 , ku si burim shkrirje eshte energjia e prodhuar nga harku elektrik. Materialet kryesore qe perdoren ne procesin e shkrirjes jane minerali i kromit, koksi metalurgjik dhe materialet fluesuese, ne rastin tone kuarci. Materale te tjera te nevojshme per procesin jane pasta e elektrodesh dhe manteli metalik qe sherbejne per te formuar elektrodën vetepjekese, materialet zjarrduruese per derdhjen nga furra te HCFeCr , argjile, shufra celiku per mbylljen dhe hapjen e grykave te derdhjes, etj.

Furrat me hark te mbyllur perdorin pergjithesisht elektroda vetepjekese. Pasta e elektrodesh shtohet vazhdimisht ne brendesi te materialit metalik te elektrodesh (kemishes se elektrodesh) dhe vetepiqet si rrjedhoje e nxehtesise qe buron nga rezistenca qe paraqet pasta ndaj kalimit te rrymes si dhe nga nxehtesia e ardhur nga furra me transmetim dhe konveksion. Te gjitha lendet e para qe futen ne furre peshohen sipas llogaritjeve dhe percaktimeve paraprake dhe perzihen qe te jene sa me uniforme per procesin e shkrirjes. Proceset e shkrirjes dhe oksido-reduktimit zhvillohen ne vatren e fures. Nga zhvillimi i vazhdueshem e i pa nderprere i ketyre proceseve krijohet ferrokromi dhe skorja te cilet ndahen nga njeri tjetri, ne nje proces normal, nga ndryshimi i madh i peshave specifike te tyre. Nga furra, HCFeCr dhe skorja derdhen ne menyre periodike ne kovat e derdhjes nepermjet grykave te derdhjes. Metali i nxehte HCFeCr derdhet ne forma dhe thyhet pas ftohjes, ne madhesite e percaktuara sipas kerkesave per perdorim. Skorja kalon ne procesin e granulimit dhe me pas ne vendin e percaktuar per mbetjet teknologjike.

Lendet e para, minerali i kromit, koncentratit, koksi, kuarci duhet te kene madhesi te pershtateshme dhe ne vecanti:

-Mineral kokerr : 0-80 mm

-Koks : 20-40mm

-Kuarci : 20-40 mm

Per te arritur kete granulometri perdoret Reparti i Thyerjes, ndersa per te bere furnizimin e duhur si me lende te para ashtu edhe me sasite respektive sherben sistemi dozimit te lendeve te para. Me ane te peshoreve elektronike te programuara sipas sasive respektive dhe ne menyre te automatizuar behet dozimi i lendeve te para te cilat me ane ten je transportieri dergohen ne nje bunker qe ndodhet ne sheshin e sherbimi, kontrollit dhe furnizimit te fures. Nga ky bunker me ane te nje ngarkuesi frontal te vogel me rrota (tip BOBCAT) behet furnizimi i fures.

Trupi i Fures eshte nje strukture stacionare cilindrike e perbere nga trupi cilindrik dhe grykat e shkarkimit te fures (grykat e derdhjes).

Karkasa cilindrike e fures

Eshte pjesa kryesore e trupit te fures. Eshte e ndertuar prej llamarine çeliku me trashesi 25 mm te kalandruar.

Karkasa e fures, per te rritur qendrueshmerine si dhe per te rritur siperfaqen ftohese, do te kete te salduara vertikalisht disa brinje perforcuese. Sasia e perforcueseve vertikale do te jete 24 flete dhe trashesia e tyre 25 mm.

Dyshemeja e karkases se fures do te jete me llamarine me trashesi 25 mm. Me llamarine 25mm do te konstruktohen dhe perforcuesit rrethore te karkases se fures.

Grykat e derdhjes.

Ne karkasen e fures jane te montuara dy gryka derdhje me ulluqet perkatese. Grykat e derdhjes jane te spostuara dhe te vendosura ne nivele te ndryshme, gje qe ben te mundur shkrijen e panderprere te mineralit te kromit dhe lendeve te tjera si dhe derdhjen e vecante te ferrokromit nga skorjet. Ky sistem i ndertimit te fures quhet me Doping Nivel dhe ka dy avantazhe shume te medha krahasuar me sistemet e tjera te prodhimit te ferrokromit:

- Rrit cilesine e produktit FeCr.
- Rrit rikuperimin e kromit qe shkon deri ne 95 %.

Sistemi i largimit te gazrave.

Sistemi i largimit te gazit nga furra perbehet nga dy tuba me diameter 1400 mm sejcili, tri valvula flutur, struktura mbajtese, tubi mbledhes i tymrave te grykave te derdhjes perfshi dhe ventilatorin. Tubat e gazit me diameter 1400 mm ne pjesen e pare te tyre jane me sistem ftohje me uje pasi gazi qe del nga furra eshte me temp 90 - 350° C. Lllamarina me te cilen pregatiten keto tuba eshte me trashesi 8mm. Te dy keto tuba se bashku bashkohen me kolektorin ne nje bashkim ne forme T, per te derguar me tej gazin ne ftohes, e me pas ne sistemin e pastrimit te filtrave me mende.

Kollonat e elektrodave

Kollona e elektrodave eshte zemra e fures se shkrijes per prodhimin e ferrokromit. Per tekrijuar kushte dhe vijushmeri normale te punes duhet te ndertohet dhe konstruktohet me shume kujdes sistemi i kolones se fures. Nyja e kollones se elektrodave perbehet nga:

- Manteli metalik i elektrodave
- Pasta e elektrodave dhe elektroda e vetpjekur
- Sistemi i mbajtjes se elektrodave ose sistemi i frenimit
- Sistemi i ulje ngritjes se elektrodave
- Sistemi i udhezimit te elektrodave
- Sistemi i ftohjes se materialit metalik te elektrodave
- Sistemi i pllakave te kontaktit

Sistemi i zgjatjes se elektrodave do te jete komandim elektrik dhe mund te jete manual nga niveli 12 m ose automatic nga kabina e komandimit te fures. Levizja e elektrodave do te behet me energji elektrike perms Martinetti me vidhosje.

Pasta e elektrodave

Eshte materiali karbonik qe pas pjekjes ne temperature te larte formon elektrodën e cila eshte nje mase solide dhe me percjellesheri te larte elektrike. Per te realizuar treguesit e projektuar cilesia e parashikuar e pastes se elektrodës do te jete:

- Karboni fiks(Cf)	85%
-Lendet volatile	10%
-Squfuri total	1%
-Fosfori	0.02%
- Hiri	5 %
-Lageshtia	1 %
-Densiteti	1640 gr/cm ³
-Rezistenca elektrike	75 ohm/wm
-Rezistenca mekanike	17-20 N/mm ²
-Granulometria	Briket(60x40mm)
-Temperatura e zbutjes	40- 60 grade C

Transformatori i furres (Tre fazor AC)

Transformatori i furres do te vendoset ne kuoten 6.5 m dhe do te kete fuqine 12.5 MVA dhe do te instalohet me gjithë pajisjet shtese te nevojeshme per komandimin dhe mbrojtjen.

Sistemi i ftohjes me uje

Sistemi i ftohjes me uje eshte garancia per pune te sigurte te gjithë perbersave te furres sepse ne menyre te vazhduesme i mban te ftohura pjeset e furres qe ngrohen. Ne menyre te pergjitheshme perbehet nga tubat e furnizimit, rezervuari i kthimit te ujit, valvula hyrese kryesore, manometrat e presionit te ujit, tubat e ujit dhe saracineskat. Per te evituar krijimin e bigorit ne sistemin e ftohjes, uji do trajtohet automatikisht para futjes ne sistem. Sasia e ujit te fresket qe do te futet ne sistem do te jete 20 l/sek. Gjithë sasia e ujit do te riciklohet gje qe ben te domosdoshme trajtimin me antialge si dhe ndertimi ne uzine te nje agregati per ftohjen e ujit. Diferenca e temperaturave te ujit ne hyrje dhe dalje do te jete jo me shume se 3° C. Per ujin qe do te perdoret per ftohjen e furres dhe te transformatorit do te perdoret sistemi Baltomore.

Pajisjet elektrike te furres

Tensioni i larte elektrik permban: Transformatorin e furres, perfshire celesat e komandimit ne ngarkese dhe ftohesisht e vajit. Panelin e tensionit te larte dhe paisjet e mbrojtjes se kompjuterit. Tensioni i ulet elektrik permban: Panelet e instrumentave mates, panelin e fuqise, panelin e punes, panelin e rrymes se vazhduar, panelin e PLC dhe kompjuterin. Gjithashtu perfshihen dhe paisjet matese te temperaturave te trupit te furres.

Pajisjet matese te kontrollit te automatizimit te furres 12000 KVA te prodhimit te ferrokromit perfshijne.

- 1.Kontrollin automatik i fuqise hyrese ne furre.
- 2.Kontrollin e sistemit te elektrodave, ngritje e komandim i tyre
- 3.Monitorimi i temperatures se veshjes se fures
- 4.Monitorim dhe sinjalizimin e qarkullimit dhe temperatures se ujit ftohes se fures
- 5.Monitorim dhe regjistrimin e te dhenave te parametrave elektrike te procesit te shkrirjes dhe te transformatorit.
- 6.Monitorimin e sistemit automatik te ngarkimit te materialeve si dhe nivelin e materialeve ne bunkierat e depozitimit.
- 7.Hartimin dhe printimin e raporteve ditore te punes se fures.

Ky sistem kontrolli eshte realizuar duke patue si baze permiresimet e kryera ne shume furra te kesaj teknologjie. Perdor strukturat e avancuara kompjuterike si dhe sistemet e avancuara te kontrollit. Krahasuar me metodat tradicionale te kontrollit, siguria e kesaj menyre kontrolli eshte rritur se tepermi, ndersa mirembajtja e sistemit eshte reduktuar ne menyre te ndjeshme. Mund te siguroje punen normale te sistemit dhe ne cdo lloj konditash nuk mund te humbas kontrollin e procesit dhe te te dhenave. Te dhenat matese kryesore, te dhenat llogaritese, te alarmeve dhe te kontrollit te sistemit merren te gjitha dhe procesohen nga PLC. Sistemi ka tri lloj metodash kontrolli, perfshi komandimin manual, komandimin automatik dhe komandimin nga distanca. Ky sistem ne menyre te sukseseshme realizon ngarkimin automatik te fures, ngritjen dhe levizjen automatike te elektrodave si dhe ne menyre automatike kontrollon rrymat dhe ben rregullimin e fuqise.

- **Furnizimi me uje**

Procesi i shkrirjes pervecse eshte nje proces i komplikuar kerkon edhe perdorimin e ujit si per ftohje te pajisjeve qe ndodhen nen efektin e temperaturave shume te larta ashtu edhe per granulimin e skorjes, ftohje te impianteve qe funksionojne ne temperatura te larta, kapjen e pluhurave dhe per pastrime te ndryshme. Nevojat e fabrikes per uje teknologjik jane 15 l/sek. Duke marre ne konsiderate vleren e ujit dhe shfrytezimin sa me racional te rezervave ujore te vendit kemi parashikuar ne skemen e perpunuar te kesaj uzine perdorimin e riciklimit te ujit duke ulur ne ne menyre te ndjeshme perdorimin e ujit te fresket. Uji teknologjik i nevojshem per pune normale te uzines do te sigurohet nga stacioni i pompimit qe do te ndertohet prane lumit te Matit qe kalon ne pjesen e poshtme te sheshit te parashikuar per ndertimin e uzines ne nje distance rreth 100 m dhe ne nje disnivel prej rreth 30 m. Ne lumin e Matit do te merret nje sasi uji prej vetem 25 litra/sekonde me ane te nje stacioni pompimi (sic mund te shihet ne planimetrine e pergjitheshme te uzines). Pjesen tjetere te ujit teknologjik do ta sigurojme me ane te riqarkullimit te tij ndermjet vaskes se ujit dhe stacionit qendror te qarkullimit te ujit.

Uji per procesin teknologjik do te kaloje ne dy procese kryesore, ne ate filtrimit dhe pastrimit mekanik nga grimcat qe jane ne suspence ne ujin qe do te mirret nga lumi i Matit dhe procesit te zbutjes per ujin qe do te perdoret ne impiantet ftohese te uzines. Procesi i zbutjes do te perdoret

vetem per ate sasi uji qe do te perdoret ne sistemet e mbyllura te ujit te cilat bejne ftohjen e elementeve te cilat jane ekspozuar ndaj nxehtesise.

Ftohja e ujit si dhe zbutja e tij behet me ane te nje sistemi te quajtur Baltimore dhe ka keto karakteristika:

Nr	Emertimi	Uji shtese	Uji i ricikluar
1	pH (25 °C)	6 - 8	6 - 8
2	Percjellshmeria elektrike ($\mu\text{V}/\text{CM}$)	< 200	< 500
3	Fortesia totale (CaCO_3) ppm	< 50	< 50
4	Baziciteti M (CaCO_3) ppm	< 50	< 50
5	Kloritet (CL) ppm	< 50	< 50
6	Ionet sulfate (SO_4) ppm	< 50	< 50
7	Hekuri (Fe) ppm	< 50	< 50

Tabela 5.Karakteristikat e Sistemit Baltimore

- **Kanalizimet**

Te gjitha ujrat teknologjike qe dalin gjate realizimit te proceseve teknologjike do te largohen me ane te kanaleve ne lumin e Matit. Duhet me theksuar edhe nje here se te gjitha ujrat qe do te dalin nga procesi do te jene ne perputhje me te gjitha normat e vendosura per mbrojtjen e mjedisit. Gjithashtu ne proces nuk perdoret asnje lende kimike dhe gjate procesit nuk krijohet asnje lende e rrezikeshme per mjedisin. Ndersa ujrat e bardha higjeno-sanitare sistemohen po ashtu ne kanalet ujembledhes te zones. Ujrat e ndotura urbane do te sistemohen me gropa septike.

- **Pastrimi i ajrit**

Pastrimi i ajrit ne kushtet e reja te krijuara dhe me kerkesat gjithnje e ne rritje te mbrojtjes se mjedisit paraqet nje rendesi te vecante. Ne llogaritjen e sistemit te pastrimit te ajrit per kete uzine jane marre ne konsiderate mjedisi ku do te ndertohet impianti, drejtimi i ererave, standartet shteterore te mbrojtjes se mjedisit.

Sistemi i pastrimit te pluhurave perbehet nga keto pjese kryesore:

- linjat e ajrit,
- pajisja ftohese,
- sistemi pneumatik,
- cikloni me efektivitet te larte,
- ventilatori,
- filtri me munge dhe sistemi i pastrimit te tij.

Ky sistem eshte projektuar duke mare ne konsiderate sasite e medha te ajrit qe do te pastrohet, eficencen e larte te pastrimit, nje ndertim racional te ketij sistemi, pune te thjeshte dhe mirembajtje sa me te thjeshte. Per te rritur efektivitetin e pastrimit ky sistem perdor ciklonin me

efektivitetet te larte i cili largon paraprakisht grimcat me te medha te pluhurit duke reduktuar ne kete menyre koncentrimin e gazrave qe shkojne ne filtrin me munge duke permiresuar efikasitetin e gjithë sistemit te pastrimit te ajrit. Te dhenat qe jane perdorur ne llogaritjen e sistemit te pastrimit te ajrit:

Emertimi	Njesia	
Furra	Nje cope	hapur
Fuqia e Fures	kWA	12000
Lartesia	m	300
Temperatura	oC	-25 oC deri ne 40 oC
Frekuenca e shkarkimit		Nje here ne ore
Temperature e gazit	oC	90-350 oC
Sasia e gazit	m ³ /ore	210000
Permbajtja e lendes se ngurte	g/Nm ³	3,6-5

Tabela 6. Te dhenat per llogaritjen e sistemit te pastrimit

Permbajtja e grimcave te ngurta ne gazin qe do te pastrohet:

< 1µm	1 - 10 µm	10 - 40 µm
> 88 %	5 %	7 %

Projektimi i sistemit te pastrimit te ajrit eshte bazuar ne keto kritere:

1. Ligjet e Republikes se Shqiperise per mbrojtjen e mjedisit
2. Ligji Nr 162/2014 "per mbrojtjen e cilesise se ajrit ne mjedis"
3. Filtri me munge per pastrimin e ajrit. Per projektimin e ketij filtri jane mare ne konsiderate keta faktore:

- Kapja e gazeve parashikohet qe te jete me e larte se 95%, efektiviteti i mbledhjes se tyre > 99% dhe koncentrimi i materialit te ngurte ne hyrje te tij 5.0 g/Nm³
- Përmbajtja e te ngurtit ne ajrin e pastruar < 25 mg/Nm³
- Jetegjatesia e qeseve prej fibrash xhami te filtrit > 12 muaj

Filtri eshte gjithashtu i pajisur me nje sistem kontrolli te kompiuterizuar, i cili eshte projektuar duke u bazuar ne sistemet me bashkohore te pastrimit te ajrit. Perfshin monitorimin dhe kontrollin e punes ne kohe reale, ndjek te dhenat dhe ne menyre automatike ben korigjimin e punes se filtrit duke bere te mundur jo vetem mbajtjen e te dhenave te programuara, por edhe siguron punen e makinerise ne kushtet me te mira te mundeshme.

• Furnizimi me energji elektrike

Furnizimi me energji elektrike i objektit ndahet ne furnizimin me energji elektrike te fures dhe furnizimin me energji elektrike te pjeseve motorike dhe per ndricim. Furnizimi primar i uzines me energji elektrike do te behet nga linja e tensionit te larte 110 Kv Ulez-Peshkopi me ane te nje

degezimi ne afersi te uzines. Uzina vete do te kete nje transformator 110/35 Kv dhe dy transformatore te tjere: njeri autotransformator per furnizimin me energji elektrike te furrës, ndersa tjetri per furnizimin e uzines per nevojat e saj motorike dhe ndricim.

Mbrojtja nga renia nen tension.

Ne teresi ne objekt eshte parashikuar mbrojtja e pajisjeve dhe makinerive ngarenia nen tension. Nga renia nen tension nuk do te mbrohen vetem pajisjet elektrike, por edhe te gjitha konstruksionet metalike dhe vendet ku ky rrezik mund te ekzisoje ose te gjenerohet.

Mbrojtja nga shkarkimet atmosferike.

Ne kuadrin e mundesive te renies se zjarrit eshte parashikuar edhe mbrojtja e objektit nga shkarkimet atmosferike. Te gjitha pajisjet me lartesi te madhe si dhe shtyllat e ndricimit do te perfshihen ne sistemin e mbrojtjes nga renia nen tension. Ky sistem i krijuar ne kete menyre merr edhe funksionin e mbrojtjes nga shkarkimet atmosferike.

Mbrojtja nga zjarri

Per mbrojtjen nga zjarri te fabrikes eshte parashikuar edhe sistemi i mbrojtjes ne baze te projektit te hartuar per kete qellim.

Perballimi i emergjencave civile

Sic eshte permendur edhe me pare, produktet qe rezultojne nga procesi teknologjik nuk jane te demshem per mjedisin apo shendentin e punonjesve dhe te banoreve ne rrethinat apo ne largesi te objektit. Per te eliminuar cdo influence te demshme vecanerisht ne ajrin qe del nga furrat e shkrires jane parashikuar te gjitha masat e nevojeshme. Por megjithate ne projekt parashikohet evakuimi i punonjesve ne menyre te sigurte ne te gjitha rastet e krijuara nga faktore natyrore ose te nje natyre tjetere qe mund te sjellin demtime per jeten e tyre. Ne projekt dhe ne plan biznesin e fabrikes parashikohen edhe masat e nevojeshme per riaftesimin e gjendje se shkaktuar nga veprimi i rrethanave emergjente.

Kontrolli sasior dhe cilesor i procesit

Kontrolli sasior dhe cilesor i procesit te pasurimit eshte shume i rendesishem, jo vetem per mbajtje te stabilizuar te treguesave te procesit, por gjithashtu edhe per kryerjen e studimeve te ndryshme per te percaktuar treguesat optimal per lloje te ndryshme mineralesh. Per kete qellim eshte parashikuar qe ne projektin e Uzines se shkrires se Kromit ne Suc te jete perfshire edhe nje laborator fiziko-kimik. Ky laborator do te sherbeje edhe per percaktimin e perbersave kimike te mineralit qe do te blihet per tu procesuar ashtu edhe te produktit te gatshem qe do te shitet.

- **Depozitimi i sterileve**

Problemi me i madh me te cilin perballen sot te gjitha fabrikat e pasurimit dhe uzinat e shkrirjes se metaleve, jo vetem ne Shqiperi por ne te gjithë boten eshte jo cujezimi dhe neutralizimi i sterileve, por kryesorja eshte depozitimi i tyre. Keto jane procese te nderlidhura ndermjet tyre dhe zgjidhja eshte e perbashket. Depozitimi i sterileve do te behet ne ate qe quhet DAMPE dhe qe vendoset ne pjesen me te poshteme te uzines ne pjesen perendimore te saj prane lumit te Matit. Damba fillestare krijohet me material nga vendi duke krijuar nje dige me lartesi 5 metra dhe me mbushjen e saj me sterile (skorje) behet ngritja e saj me vete materialin e mbledhur gjate kohes. Perberja e skorjes qe do te depozitohet eshte e pademshme per mjedisin dhe mund te manipulohet ne menyre te thjeshte me mjete ngarkuese. Sic eshte permendur edhe me lart skorjet qe rezultojne nga procesi i prodhimit te ferrokromit rezultojne te jene te granuluara me madhesi te grimcave nen 5 mm. Duhet me theksuar se ne proces nuk perdoret asnje lloj kimikati dhe i gjithë procesi zhvillohet ne prani te ujit. Gjithashtu edhe gjate procesit nuk krijohet asnje lende apo produkt i demshem. Produktet qe rezultojne nga procesi i perpunimit si hedhurine (skorjet) jane mjaft te pershtateshme per perdorim ne industrine e materialeve te ndertimit per prodhimin e cimentos. Mbi kete baze Dampa qe do te ndertohet per kete uzine ka kapacitet depozitues te kufizuar, por me mundesi te mjaftueshme zgjerimi ne te ardhmen.

- **Fuqia punetore**

Fuqia punetore per te siguruar nje pune te vazhdueshme dhe cilesore te uzines eshte nj faktor shume i rendesishem dhe nje nga aresyet qe per ndertimin e kesaj uzine ne zonen e Sucit eshte jo vetem afersia me burimin e lendes se pare, energjise elektrike dhe ujit, por edhe ekzistenca ne qytetin e Burrelit te nje mundesie per te siguruar fuqi punetore te specializuar ne ish uzinene e Ferrokromit te ketij qyteti.

Uzina do te kete gjithsej 79 punonjes te ndare ne reparte dhe kualifikime sipas tabelës se meposhteme:

EMERTIMI	SASIA	POZICIONI	KUALIFIKIMI	TURNE
Drejtori Pergjithshem	1	Drejtor	Universitet	1
Personeli,IT,Sekret	1	Burimet njerezore	Universitet	1
	1	IT	Universitet	1
	3	Security dhe Sekret	Shkolle mesme	1
Financa/Administrata	1	Kryefinancier	Universitet	1
	1	Llogaritar	Shkolle mesme	1
	1	Magaznier	Shkolle mesme	2
Repartet ndihmes	1	Pergjegjes	Shkolle mesme	1

		transporti		
	2	Fadromista	Teknik	2
	1	Shofere	Teknik	2
	2	Peshuesa	Shkolle mesme	2
	1	Zevendesues	Teknik	2
Totali Administrata	16			
Prodhimi	1	Drejtor Prodhimi	Inxhinier	1
Mirembajtja	1	Pergjegjes Oficine	Inxhinier	1
	7	Mekanike dhe saldatore	Teknik	1
	3	Xhenerik	Teknik	1
	4	Elektriciste	Teknik	1
Tyerja	3	Punetore turni	Teknik	1
Punonjes te Fures	4	Pergjegjes turni	Shkolle mesme	4
	8	Punetore ngarkimi	Teknik	4
	2	Furnizuesa	Teknik	4
	12	Metalurge	Teknik	4
	4	Mekanike	Teknik	4
	4	Elektriciste	Teknik	4
	4	Zevendesuesa	Teknik	4
Cilesia /Laboratori	1	Pergjegjes Cilesie/ Lab	Inxhinier	1
	2	Laborante	Shkolle mesme	1
Punetore ndihmes	1	Shofer	Shkolle mesme	1
	1	Zevendesues	Shkolle mesme	2
Prokurimi	1	Pergjegjes per blerjet	Universitet	1
Totali Prodhimi	63			
Total	79			

1.4 Infrastruktura e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja

Sigurimi i ujit

Sigurimi i ujit do të bëhet nëpërmjet sistemit të pompave që do të vendoset në afërsi të Lumit Mat në një distancë rreth 100 m dhe në një nivel prej rreth 30 m që do të përdoren si në fazën e ndërtimit ashtu dhe gjatë fazës operacionale.

Nevoja për karburante është parashikuar të jetë rreth 70 mijë litra /vit, duke e siguruar nga subjektet private të licensuara.

Kanalizimet

Ndërsa ujrat e bardha higjieno-sanitare sistemohen po ashtu në kanalet ujembledhëse të zonës. Ujrat e ndotura urbane do të sistemohen me gropa septike.

Energjia elektrike do të sigurohet nga transformatori, cili do të furnizojë uzinën dhe do të jetë 16000 KVA, Transformatori do të ushqehet prej rrjetit kombëtar 110 KV nga linja e tensionit të lartë Burrel - Bulqizë. Kapaciteti i transformatorit të furrës do të jetë 9000 KVA.

Rruga lidhëse e objektit me atë nacionale është lehtësisht e zgjidhshme pasi në anën jugore të objektit në distancë rreth 20-30 m, është trase e hapur e cila me disa përmirësime do të shërbejë si rrugë lidhëse transporti me rrugën nacionale e cila është jo më larg se 400 m nga ky objekt.

1.5 Programi për kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit dhe fazën e rehabilitimit.

Ndërtimi i Uzinës do të ndjekë vetëm një fazë zhvillimi. Periudha kohore e parashikuar nga fillimi deri në përfundimin e punimeve sipas grafikut të punimeve parashikohet rreth 2 muaj dhe përfshin:

Ndërtimin e repartëve teknologjike, rrugëve të brendshme, linjën elektrike të tensionit të lartë, stacionet e pompave dhe linjën e ujit teknologjik, montimin e makinerive dhe instalimet teknologjike. Me përfundimin e tyre Uzina do të vihet në punë.

Për ndërtimin e strukturës së objekteve që propozohen nevojitet kryerja e punimeve të gërmimit. Gërmimi duhet për themelet të cilat janë menduar të zgjidhen me struktura masive betoni të armuar. Këto themele do të shërbejnë njëkohësisht edhe si dysheme të repartëve të fabrikës.

Volumi i dherave të parashikuar që do të dalë nga gërmimi dhe nga kryerja e punimeve do të përdoret për krijimin e digës së dampës së sterileve.

Pas përfundimit të fazës ndërtimore do të ndërmerren këto veprime për rehabilitimin mjedisor të zonës së projektit:

- Pastrim i zonës së punës nga materiale të dala nga përdorimi dhe të lendeve të para
- Zhvendosje e materialeve shtesë siç do të bëhet dakord me subjektin

- Mbulimi i skarpatave te bazamentit , ku eshte e mundur, me shtrese toke siperfaqesore per lejimin e mbirjes se bimesise natyrore.

1.6 Lendet e para qe do te perdoren per ndertimin dhe menyra e sigurimit te tyre (materiale ndertimi, uje dhe energji)

Lendet e para

Te gjitha lendet e para qe do te perdoret ngjate fazes se ndertimit te uzines do te merren nga subjekte te licensuara dhe ne perputhje me gjithe ligjet ne fuqi te Republikes se Shqiperise.

Per punimet e ndertimit, kompania do te perdor inerte, uje e çimento te cilat sigurohen direkt nga subjektet e licensuara.

Konkretisht :

-Rreth **10 000 m³** betone,

-çimento mbi **250 ton**

- hekur per konstruksione metalike rreth **1000 ton etj.**

Keto do te sakesohen me perfundimin e projekteve te zbatimit.

Gjate fazes operacionale uzina do te funksioneje duke u furnizuar me lende te pare krom nga Minierat e Kromi ne Bulqize (te licensuara) , duke shfrytezuar dhe afersine me kete zone.

Sigurimi i ujit

Sigurimi i ujit do te behet nepermjet sisitemit te pompomit qe do te vendoset ne afersi te Lumit Mat ne nje distance rreth 100 m dhe ne nje disnivel prej rreth 30 m qe do te perdoren si ne fazen e ndertimit ashtu dhe gjate fazes operacionale

Nevojat e fabrikes per uje teknologjik sic e pershkruam me lart jane 20 l/sek. Duke marre ne konsiderate vleren e ujit dhe shfrytezimin sa me racional te rezervave ujore te vendit eshte parashikuar ne skemen e perpunuar te kesaj uzine perdorimin e riciklimit te ujit duke ulur ne menyre te ndjeshme perdorimin e ujit te fresket.

Ndersa nevoja per uje te pishem parashikohet te jete rreth 1.5 l/sek, sasi kjo qe do te sigurohet ne marrveshje me organet vendore nga burime ne afersi.

Energjia elektrike do te sigurohet nga transformatori, cili do te furnizoje uzinen dhe do te jete 16000 KWA, Transformatori do te ushqehet prej rrjetit kombetar 110 KV nga linja e tensionit te larte Burrel - Bulqize. Kapaciteti i tranformatorit te fures do te jete 9000 KVA.

Nevoja per karburante eshte parashikuar te jete rreth 70 mije litra/vit, duke e siguruar nga subjektet private te licensuara.

Fuqia punetore

Fuqia punetore per te siguruar nje pune te vazhdueshme dhe cilesore te uzines eshte nje faktor shume i rendesishem dhe nje nga arsyet qe per ndertimin e kesaj uzine ne zonen e Sucit eshte jo vetem afersia me burimin e lendes se pare, energjise elektrike dhe ujit, por edhe ekzistenca ne qytetin e Burrelit te nje mundesie per te siguruar fuqi punetore te specializuar ne ish uzinene e Ferrokromit te ketij qyteti.

Uzina parashikohet te kete gjithsej 79 punonjes te ndare ne reparte dhe kualifikime te ndryshme

1.7 Informacion për lidhjet e mundshme te projektit me projekte te tjera ekzistuese përreth/pranë zonës te projektit

Nuk ka informacion specifik per projekte te tjera te ekzistuese ne zonen perreth. Vete zona eshte nje zone e pabanuar gje qe ben dhe me te lehte ndertimin e kesaj uzine, Gjithashtu afersia me burimet e mineralit te kromit ben kete zone nje nga zonat me te volitshme per ndertimin e kesaj uzine

1.8 Përdorimin e lendeve te para gjate funksionimit, përfshirë sasi të e ujit te nevojshëm, energjisë, lendeve djegëse dhe mënyrën e sigurimit te tyre

Gjate fazes operacionale uzina do te funksioneje duke u furnizuar me lende te pare krom nga Minierat e Kromi ne Bulqize (te licensuara), duke shfrytezuar dhe afersine me kete zone

Sigurimi i ujit

Sigurimi i ujit do te behet nepermjet sisitemit te pompomit qe do te vendoset ne afersi te Lumit Mat ne nje distance rreth 100 m dhe ne nje disnivel prej rreth 30 m qe do te perdoren si ne fazen e ndertimit ashtu dhe gjate fazes operacionale

Nevojat e fabrikes per uje teknologjik sic e pershkruam me lart jane 20 l/sek. Duke marre ne konsiderate vleren e ujit dhe shfrytezimin sa me racional te rezervave ujore te vendit eshte parashikuar ne skemen e perpunuar te kesaj uzine perdorimin e riciklimit te ujit duke ulur ne menyre te ndjeshme perdorimin e ujit te fresket.

Ndersa nevoja per uje te pishem parashikohet te jete rreth 1.5 l/sek, sasi kjo qe do te sigurohet ne marrveshje me organet vendore nga burime ne afersi.

Energjia elektrike do te sigurohet nga transformatori, cili do te furnizoje uzinen dhe do te jete 16000 KWA, Transformatori do te ushqehet prej rrjetit kombetar 110 KV nga linja e tensionit te larte Burrel - Bulqize. Kapaciteti i tranformatorit te fures do te jete 9000 KVA.

Karburant Nevoja per karburante eshte parashikuar te jete rreth 70 mije litra /vit, duke e siguruar nga subjektet private te licensuara.

Fuqia punetore

Fuqia punetore per te siguruar nje pune te vazhdueshme dhe cilesore te uzines eshte nje faktor shume i rendesishem dhe nje nga arsyet qe per ndertimin e kesaj uzine ne zonen e Sucit eshte jo vetem afersia me burimin e lendes se pare, energjise elektrike dhe ujit, por edhe ekzistenca ne qytetin e Burrelit te nje mundesie per te siguruar fuqi punetore te specializuar ne ish uzinene e Ferrokromit te ketij qyteti.

Uzina parashikohet te kete gjithsej 79 punonjes te ndare ne reparte dhe kualifikime te ndryshme

1.9 Aktivitete te tjera qe mund te nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.

Nuk do te kemi ndertim te kampit pasi punonjesit do te sigurohen nga zona perreth Burrel apo dhe fshatrat me te afert,duke iu siguruar transportin e perditshem,ne kete menyre do te kemi rritje te punesimit.

1.10 Analizimi i alternativave të mundshme për zbatimin e projektit

Referuar kerkesave tekniko-ekonomike e infrastruktures qe kerkohet si dhe faktoreve te siperpermendur rezulton se sheshi ku do te ndertohet uzina, qe eshte perzgjedhur ka keto avantazhe:

-Eshte toke private, pa konflikt pronesie;

-Ne kete siperfaqe nuk ka ndonje bimesi qe demtohet, vetem barishte te zakonshme per mjedise te tilla kodrinore, fushore.

-Topografia e sheshit qe mendohet per shfrytezim eshte e tille qe lejon kushte gjeologo-inxhinierike per ndertime te tilla, se bashku me venddepozitimin per mbetjet e ngurta.

-Avantazh eshte fakti se ne afersi te objektit, ushtrojne aktivitet minerar disa subjekte te cilat sherbejne si burim furnizimi te uzines me lende te pare.

-Ka mundesi furnizimi me uje e energji elektrike pa ndikuar ne zone.

-Nuk ka afer zone te banuar, objekte social-kulturore, mjedise kreative, apo objekte qe mbrohen me ligj.

-Ka mundesi lidhje me rrjetin rrugor nacional per transportin e duhur si te lendes pare te zeheroreve te ferro- kromit edhe te koncentrat kromi.

-Ne afersi te sheshit nuk kemi grumbullime ujrash siperfaqesore nga kodrinat perreth, sepse jane shume larg nga objekti

-Struktura e formacionet gjeologo-inxhinierike krijojne mundesi depozitimi mbetjesh industriale te ngurta ne sheshin perkates pjese organike e projektit, pa patur infiltrime, natyrisht duke zbatuar masat mbrojtese per te tilla dampa.

-Nuk ka ne afersi kanalizime e kullime qe lidhen me bujqesine etj. pra nuk ka fare ndikim ne zone ne lidhje me furnizim me uje etj.

Ne disavantazhe mund te permendim

-Periudha e dimrit krijon veshtiresi ne lidhje me furnizim e transport nga debora e ngricat;

-Ndersa transporti i makinerive dhe paisjeve per ne objekt nuk do te kete problem sepse rruga eshte e pershtatshme dhe e asfaltuar.

Projekti qe parashikohet te zbatohet eshte ndertim e shfrytezim i uzines per prodhimin e ferrokromit me karbon te larte.

1.11 Informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin te kërkuara nga legjislacioni ne fuqi si dhe institucionet kompetente për lejimin/autorizimin/liçencimin e projektit

Aktiviteti prodhues realizohet ne nje zone e cila nuk eshte perfshire ne listen e zonave te mbrojtura me ligj. Ky projekt eshte ne sinkronizim te plote me programet e zhvillimit per zonen Veri lindore, e cila eshte e pasur me lende te para krom mbajtese, si dhe ndikon ne rritjen e vlerave te mineraleve te varfera te kromit duke siguruar nje treg konkurues.

Njekohesisht projekti eshte ne perputhje te plote me politikat e Qeverise, per nxitjen e biznesit si nje element i rendesishem ne rritjen e nivelit te jeteses.

Shoqeria duhet te pajiset me Deklarate Mjedisore per zhvillimin e aktivitetit per ‘Ndertim dhe funksionim te Uzines se Ferro-Kromit’

Institucionet pergjegjese

1. Ministria e Mjedisit
2. Agjensia Kombetare e Mjedisit